REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, 14 dhe 17 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 9 shkronja (h), 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Shkresën përcjellëse 02.2383-2/26 datë 02.06.2026 të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit 15Nr.353/01-20083, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

VENDIM
NDRYSHIMIN E TITULLARIT TË PALUAJTSHMERISË
NGA SHKOLLA BUJQËSORE NË SHKOLLËN FILLORE E MESME E ULËT "VËLLEZËRIT FRASHËRI" NË LIPJAN

Neni 1

NDRYSHOHET emërtimi i titullarit të paluajtshmërive në njësitë kadastrale P-71409044-00846-8 në vendin e quajtur "Bezimeni" me sipërfaqe prej 19057m² e evidentuar në certifikatën e pronësisë Nr.1152/2026 në ZK-Lipjan, nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" Në Lipjan

Neni 2

Ndryshimi i titullarit ashtu siç u cek në nenin 1 të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ristrukturimit të shkollave të qytetit të Lipjanit dhe bartjes së pronësisë të njësisë kadastrale me sipërfaqen e lartëcekur nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, si pjesë e interesit publik.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit nga Shkolla Bujqësore në Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web-faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-463/06-29375
Lipjan, më 30.06.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
KUVENDI I KOMUNËS
SKUPŠTINA OPŠTINE
OPŠTINA LIPLJAN
REPUBLIKA KOSOVA
XV